



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 05 nëntor 2020
Nr. ref.:RK1637/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI45/19

Parashtrues

Komuna e Vushtrrisë

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit
Ac. nr. 4858/2018 të 19 shkurtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
SelveteGërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
RadomirLaban, gjyqtar
RemzijeIstrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore të parashtruesit të kërkesës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 4858/2018 të 19 shkurtit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 44 [Liria e Asociimit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si rezultat i vendimeve kundërrthënëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 mars 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 15 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi kërkesën edhe Gjykatës së Apelit.
8. Më 31 janar 2020, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta plotësoj formularin zyrtar të kërkesës.
9. Më 7 tetor 2020, pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 6 maj 2018, Drejtoria për Arsim nën administrimin e parashtruesit të kërkesës e pensionoi I.L., për shkak të moshës.
11. Më 11 shtator 2018, I.L. parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës t'ia paguaj 3 paga në emër të shpërblimit jubilar dhe 3 paga në emër të pagave përcjellëse të pensionit.

12. Më 26 tetor 2018, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin C. nr. 408/18] e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesëpadinë e I.L. për pagimin e 3 pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe 3 paga në emër të pagave përcjellëse për pensionim. Si arsye themelore për refuzimin e kërkesëpadisë, Gjykata Themelore deklaroi: *“paditësit nuk i takon e drejta në shpërblimin jubilar dhe paga përcjellëse, pasi që është fakt i pakontestuar se i njëjti nuk është anëtar i sindikatës së bashkuar të arsimit, shkencës dhe teknologjisë, referuar nenit 35, par. 8 dhe 9 të kontratës kolektive të arsimit”*.
13. Më 2 nëntor 2018, kundër aktgjykimit [C. nr. 408/18] të Gjykatës Themelore, I.L. parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të *“zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
14. Më 19 shkurt 2019, Gjykata e Apelit [me Aktgjykimin Ac. nr. 4858/2018] e aprovoi ankesën e I.L. dhe e ndryshoi Aktgjykimin [C. nr. 408/18] e Gjykatës Themelore të 26 tetorit 2018, në mënyrë që ajo të aprovojë kërkesëpadinë e parashtruesit për pagimin e 3 pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe 3 paga në emër të pagave përcjellëse për pension. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata e Apelit deklaroi, ndër të tjera: (i) *“se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale nga neni 35,8, lidhur me par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar Gjykata e Apelit i mori si të drejta dhe të sakta dhe se mbështetja e gjykatës së shkallës së parë në dispozitat në tekstin e kontratës se duhet të jetë anëtar, nuk mund të aplikohet pasi kjo do të ishte diskriminuese dhe do të ishte një kushtëzim për anëtarësim sindikal për realizimin e të drejtave, pastaj kjo cenon të drejtën apo lirinë e asocimit në organizatat sindikale, cenon parimin e barazisë,”* dhe se (ii) kërkesëpadia e I.L., *“gjen mbështetje në nenet 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014 e cila nuk përmban dispozitë kushtetuese se punëtori duhet të jete anëtar i sindikatës, e Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar, me rastin e lidhjes dhe nënshkrimit si pikë referimi ka marrë të njëjtën marrëveshje pra bazohet në parimet e asaj marrëveshjeje po ashtu kjo dispozitë nuk mund të aplikohet pasi është në kundërshtim me nenin 24 dhe 44 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Andaj duke u bazuar në faktin se paditësit tani me vendimin e ndryshuar i takon e drejta në tri paga përcjellëse dhe në bazë të përvojës 22 vite e 4 muaj e 18 ditë (apo thënë më shkurt nën 30 vite) i takon e drejta në lartësinë e 75 % të një page bazë për periudhën 20 vjeqare të përvojës së punës”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 24 dhe nenin 44 të Kushtetutës.
16. Parashtruesi theksoi në mënyrë specifike që në një rast tjetër, i cili sipas tij përmban rrethana identike faktike dhe juridike si ato në rastin e tij, Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj kishte vendosur ndryshe nga vendimi i kontestuar. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit, për shkak se kishte vendosur ndryshe në dy raste identike, kishte shkelur të drejtën e tij për barazi para Ligjit dhe lirisë së asociimit, të garantuar me nenet 24 dhe 44 të Kushtetutës, përkatësisht parashtruesi i kërkesës i sjell dy nenet e

përmendura të Kushtetutës në lidhje me shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të gjitha si rezultat i vendimeve kontraktore gjyqësore të Gjykatës së Apelit.

17. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që kërkesën e tij (i) ta deklarojë të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24 dhe 44 të Kushtetutës; (iii), ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 4858/2018 të 19 shkurtit 2019; dhe (iv) ta kthejë rastin në rigjykim.

Dispozitat relevante ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 22

[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

[...]

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të

individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

[...]

Neni 44

[Liria e Asociimit]

1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.
2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve.
3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.

Kontrata kolektive e arsimit në Kosovë

(e nënshkruar më 18.04.2017)

[...]

Neni 35

8. Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë:

- 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë
- 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë
- 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë
- 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% jedne të një page bazë.
- 8.5 Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse.
- 8.6 Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti.

9. Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës

(e nënshkruar më 18.03.2014 dhe ka hyrë në fuqi më 01.01.2015)

[...]

Neni 52

Shpërblime jubilarë

1. I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:

1.1. për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij;

1.2. për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij;

1.3. për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.

2. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë.

3. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.

Neni 53

Kompensimi në rast të pensionimit

I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

20. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili parasheh: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

21. Në vijim, Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret tjera të pranueshmërisë, siç përcaktohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

22. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve të pranueshmërisë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin Ac. nr. 4858/2018 të Gjykatës së Apelit të 19 shkurtit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të cilat janë të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
23. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon në kërkesën e tij se me Aktgjykimin e kontestuar është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenet 24 dhe 44 të Kushtetutës.
24. Gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi, Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) parasheh:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

25. Rregulli i mësipërm, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, mundëson që kjo e fundit të deklarojë kërkesat e papranueshme, sepse ato lidhen me meritat e një rasti, përkundër faktit se një kërkesë mund të plotëson kërkesat zyrtare dhe procedurale të pranueshmërisë siç përcaktohen në Ligj dhe Rregulloren të punës. Më saktësisht, mbi bazën e këtij rregulli, Gjykata mund ta deklarojë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pasi të ketë vlerësuar meritat e saj, përkatësisht nëse konstaton se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
26. Në këtë drejtim, dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e këtij rasti, të vlerësoj nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata së pari do të rikujtojë përmbajtjen e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave Gjykata do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në pajtim me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

27. Në lidhje me këtë dhe mbi të gjitha, Gjykata rikujton se, në bazë të vendimit të saj të 6 majit 2018, parashtruesi i kërkesës për shkak të arritjes së moshës së pleqërisë kishte pensionuar I.L. Më 11 shtator 2018, I.L. parashtroi padi pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, për pagesën e 3 pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe 3 paga në emër të pagave përcjellëse për pensionim. Gjykata Themelore refuzoi padinë e tij për pagimin e 3 pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe 3 pagave në emër të pagave përcjellëse për pensionim si të pabazuara. Megjithatë, Gjykata e Apelit e aprovoi ankesën e I.L. si të bazuar dhe e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit deklaroi se në dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të 18 marsit 2014, nuk ka asnjë detyrim që një punonjës të jetë anëtar i sindikatës, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën për shpërblim jubilar dhe pagës për pension dhe se paragrafi 9 i nenit 35.8 i Marrëveshjes Kolektive të Arsimit në Kosovë nuk mund të zbatohet, sepse kjo do të ishte diskriminim dhe anëtarësimi në sindikatë do të ishte kusht për realizimin e të drejtave, më pas kjo cenon të drejtën ose lirinë e bashkimit në organizatën sindikale, cenon parimin e barazisë. Prandaj, Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe aprovoi kërkesëpadinë e I.L. për pagimin e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse për pension.
28. Prandaj, në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se Gjykata e Apelit, duke nxjerrë dy vendime të ndryshme në rrethana identike si në aspektin faktik, po ashtu edhe në atë ligjor, kishte shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 22 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 44 [Liria e Asociimit] të Kushtetutës. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së barazisë para Ligjit dhe Lirisë së Asociimit. Parashtruesi i kërkesës nuk deklaroi konkretisht shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, por në thelb lidh shkeljen e neneve 24 dhe 44 të Kushtetutës me shkeljen e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të gjitha si rezultat i vendimeve gjyqësore kontradiktore të Gjykatës së Apelit.
29. Prandaj, në adresimin e pretendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i referohet parimeve të përgjithshme përkritazi me mungesën e konsistencës të vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
- (i) Parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës*
30. Gjykata fillimisht thekson se parimet dhe kriteret e vendosura nga GJEDNJ, kjo Gjykatë gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërtënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj gjyqësore. (Shih rastet e Gjykatës KI87/18, parashtrues "IF Skadeforsikring", Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019 dhe KI35/18, parashtrues Bayerische Versicherungsverband, Aktgjykim, i 6 janarit, ku Gjykata, ndër të tjera, konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së).

31. Në dritën e zhvillimit të parimeve të përgjithshme përkitazi me mungesën e konsistencës të vendosura përmes praktikës gjyqësore, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ e cila ka theksuar vazhdimisht se një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike (shih rastin e GJEDNJ-së *Brumărescu kundër Rumanisë* [DHM], kërkesa nr. 28342/95, paragrafi 61) e cila, ndër të tjera, garanton një siguri të caktuar në situata juridike dhe kontribuon në besimin publik në gjykata (shih, *mutatis mutandis*, *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 38155/02, Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 38, dhe rastin *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56).
32. Sipas GJEDNJ-së “prezenca e vendimeve kundërthënëse gjyqësore, në anën tjetër, mund të krijojë situata të pasigurisë juridike, e cila do ta ulte besimin e publikut në sistemin gjyqësor”. (shih rastin *Paduraru kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 63252/00, paragrafi 98; *Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë*, kërkesat nr. 44698/06, paragrafi 56, Aktgjykim i 1 dhjetorit 2009; dhe rasti *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, të cituar më lart, paragrafi 38). GJEDNJ, megjithatë, ka specifikuar se nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore. (Shih rastin *Unédic kundër Francës*, kërkesa nr. 20153/04, paragrafi 74, 18 dhjetor 2008, dhe shih rastin e cituar më lart *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, paragrafi 56, shih po ashtu rastin e cituar më lart të Gjykatës KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 65, si dhe rastin KI 42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2018, paragrafi 33).
33. Po ashtu, mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor i bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial, dhe një shmangie mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë, e cila shmangie, nuk mund të konsiderohet e kundërt në vetvete. (shih rastin *Santos Pinto kundër Portugalisë*, kërkesa nr. 390005/04, paragrafi 41, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41, shih po ashtu rastin e Gjykatës KI87/17, parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, të cituar më lart, paragrafi 66).
34. Në vijim, GJEDNJ ka vendosur tri kritere themelore, të cilat janë pranuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat përcaktojnë si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime “të thella dhe afatgjata” në praktikën gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe në çfarë mase (Në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr. 1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës të cituar më lart, KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, paragrafi 39, KI87/17 parashtrues “*IF Skadiforsikring*”, paragrafi 67, të cituar më lart, KI35/18 parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”,

paragrafi 70, KI107/19, parashtgues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020).

35. Gjykata vëren se GJEDNJ gjatë zhvillimit të konceptit të “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” gjithashtu mori parasysh nëse mospërputhja është e izoluar apo afekton një numër të madh njerëzish (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 135).
36. Gjykata në këtë drejtim gjithashtu thekson se GJEDNJ nuk ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në raste të praktikës divergjente gjyqësore edhe nëse e njëjta ka afektuar një numër të madh njerëzish në lidhje me të njëjtën çështje gjatë një periudhe të shkurtër kohore para se kundërthëniet përkatëse të zgjidheshin nga gjykatat më të larta, duke u dhënë mundësi kështu mekanizmave shtetërorë që të sigurojnë konsistencën e duhur. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafët 42 - 43).
37. Kjo e fundit ndërlidhet me kriterin e dytë dhe të tretë, përkatësisht me ekzistencën e një mekanizmi të aftë për të zgjidhur mospërputhjet në praktikën gjyqësore dhe nëse ky mekanizëm është përdorur dhe në çfarë mase. Në këtë drejtim, GJEDNJ fillimisht ka konstatuar se mungesa e një mekanizmi të tillë përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst, *Tudor Tudor kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 4 marsit 2009, paragrafët 30-32; dhe *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 2 shkurtit 2010, paragrafët 37-38; dhe *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 54).

(ii) Zbatimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

38. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e elaboruara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave GJEDNJ trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe në çfarë mase në rrethanat e rastit konkret.
39. Fillimisht, Gjykata duhet gjithashtu të ritheksojë se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e gjykatave duhet të respektohet (shih rastin e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, cituar më lartë, paragrafi 118, shih po ashtu rastet e Gjykatës KI87/18 parashtgues *IF Skadeforsikring* dhe KI35/18, parashtgues *Bayerische Versicherungsverband*, të cituara më lart).
40. Përveç kësaj, parashtguesit e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, duhet t’ia paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi

me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e cituar më lart KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 76).

41. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kontekst të pretendimit të tij për cenim të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit, ka dorëzuar në Gjykatë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1569/18] të 23 korrikut 2018, për të cilin pretendon se rasti i tij ngërthen rrethana të njëjta faktike dhe juridike me ato të rastit të vendosur përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4858/2018] të 19 shkurtit 2019. Përveç Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1569/18] të 23 korrikut 2018, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë vendim të Gjykatës së Apelit apo të gjykatave tjera të rregullta.
42. Në rastin [Ac. nr. 1569/18], të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se kjo çështje ka të bëjë me një padi për pagimin e pagës jubilarë, të parashtruar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri. Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega n[Vushtrri e refuzoi këtë padi si të pabazuar. Prandaj, Gjykata e Apelit, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, vërtetoi arsyetimin e Gjykatës Themelore dhe e refuzoi këtë ankesë si të pabazuar. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit iu referua Marrëveshjes Kolektive për Arsimin Parauniversitar. Gjykata e Apelit gjithashtu konstatoi se në këtë rast, fakti që paditësi nuk ishte anëtar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës dhe nuk e pagoi anëtarësinë nuk ishte një bazë për refuzimin e kërkesëpadisë, por sepse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk u zbatua, ndërsa është dashur ta refuzojë kompensimin për pagën jubilarë dhe pagat përcjellëse për pension për shkak të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e cila ndaloi së zbatuari nga 1 janari 2018 dhe të gjitha kërkesat e paraqitura pas 01.01.2018, nuk mund të pranohen nga ana e gjykatës, sepse ato janë paraqitur pas skadimit të kësaj marrëveshje. Megjithatë, për dallim nga rasti i parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit në Aktgjykimin [Ac. nr. 1569/18] të 23 korrikut 2018, e refuzoi ankesën e paditësit, të parashtruar kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e shkallës së parë. Gjykata e Apelit, *“e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par. 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptimin të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Gjykata e Apelit ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale”*.

43. Gjykata duke marrë parasysh pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit në dy raste identike ka vendosur ndryshe, Gjykata rikujton se në rastet KI87/18 dhe KI35/18, ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore, në rastin KI87/18 në vlerësimin e 3 (tre) rasteve të Gjykatës Supreme, të nxjerra në një periudhë kohore 3 (tre) vjeçare, dhe në rastin KI35/18 në vlerësimin e 9 (nëntë) rasteve të Gjykatës Supreme të nxjerra në një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare dhe pasi kishte konstatuar se (i) kishte *“dallime të thella dhe afatgjata”*; (ii) mekanizmi i Gjykatës Supreme për harmonizimin e praktikës gjyqësore ekzistonte; por se (iii) mekanizmi i lartpërmendur nuk ishte përdorur (shih rastet e Gjykatës KI87/18, cituar më lart, paragrafi 79 dhe paragrafët 81 deri 85, dhe rastin KI35/18, cituar më lart, paragrafi 70 dhe paragrafët 110-111).
44. Në anën tjetër, Gjykata në rastet e saj KI29/17, KI42/17, KI35/18 dhe KI107/19 kishte vlerësuar, se nuk mund të konstatohen *“dallime të thella dhe afatgjata”*, në krahasimin e vetëm 2 (dy) rasteve edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse. Në këtë rast, në një rrethanë të tillë, ku parashtruesit i referohen vetëm një vendimi, i cili përmban konstatim dhe përfundim ndryshe nga vendimi, i nxjerrë në rastin e parashtruesve, Gjykata nuk kishte konstatuar se ishte cenuar parimi i sigurisë juridike. (Shih rastet KI29/17, cituar më lart, paragrafi 53, KI42/17, cituar më lart, paragrafi 44, KI35/18, cituar më lart, paragrafët 104 dhe 114, dhe KI107/19, cituar më lart, paragrafi 75).
45. Njëjtë, në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë vetëm një vendim, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1569/18] të 23 korrikut 2018, për të cilin rast përmes dorëzimit të një kopjeje të këtij aktgjykimi në lidhje me këtë rast ka dëshmuar ngjashmërinë faktike dhe juridike me atë të rastit të tij. Megjithatë, duke iu referuar këtij rasti në të cilin është thirrur parashtruesi i kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj [Ac. nr. 1569/18] të 23 korrikut 2018 konstatoi se gjykata e shkallës së parë kishte vendosur drejtë mbi bazën e provave të dhëna në lidhje me gjendjen faktike dhe se i njëjti nuk ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe për këtë arsye kishte vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore.
46. Nga ana tjetër, në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin [Ac. nr. 4858/2018] konstatoi që *“[...] Sa i përket pretendimit të ankuesit, se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale nga neni 35,8, lidhur me par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar Gjykata e Apelit i mori si të drejta dhe të sakta dhe se mbështetja e gjykatës së shkallës së parë në dispozitat në tekstin e kontratës se duhet të jetë anëtar, nuk mund të aplikohet pasi kjo do të ishte diskriminuese dhe do të ishte një kushtëzim për anëtarësim sindikal për realizimin e të drejtave, pastaj kjo cenon të drejtën apo lirinë e asocimit në organizatat sindikale, cenon parimin e barazisë.*
E drejta e paditësit gjen mbështetje në nenet 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014 e cila nuk përmban dispozitë kushtetuese se punëtori duhet të jete anëtar i sindikatës, e Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar, me rastin e lidhjes dhe

nënshkrimin si pikë referimi ka marrë të njëjtën marrëveshje pra bazohet në parimet e asaj marrëveshjeje po ashtu kjo dispozitë nuk mund të aplikohet pasi është në kundërshtim me nenin 24 dhe 44 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.

47. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit pranoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë ashtu që ta pranojë kërkesëpadinë e parashtruesit për pagimin e 3 pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe 3 pagave në emrin e pagave përcjellëse të pensionit.
48. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është i arsyetuar dhe se interpretimi i Gjykatës së Apelit, sa i përket fakteve të paraqitura për vlerësim nga parashtruesi i kërkesës, nuk mund të thuhet se ishte arbitrar, i paarsyetuar apo të ketë mundur të ndikojë në gjykim të drejtë, por ishte thjesht çështje e interpretimit dhe zbatimit të ligjit. (Shih në mënyrë analoge, rastin KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, të cituar më lart, paragrafi 57).
49. Duke rikujtuar detyrimin e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës që parashtruesit e kërkesës duhet ti paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore, Gjykata vëren se përveç dorëzimit të një rasti të vetëm, dhe referimit në ngjashmërinë e rrethanave faktike dhe juridike me ato në rastin e parashtruesit, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që Gjykatës ti paraqesë argumente shtesë, apo raste tjera që janë vendosur ndryshe nga Gjykata Supreme, dhe rrjedhimisht ta mbështesë pretendimin e tij për cenim të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës së Apelit.
50. Andaj, në dritën e praktikës së vet gjyqësore, Gjykata vlerëson se nuk është e mundur të konstatohet ekzistimi i *“dallimeve të thella dhe të vazhdueshme”* në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit që rrezikojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur vetëm në një Aktvendim të Gjykatës së Apelit, të nxjerrë 7 (shtatë) muaj më herët. (Shih në mënyrë analoge rastin KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, të cituar më lart, paragrafi 53)
51. Prandaj, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënëse, as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, si dhe as mënyra se si Gjykata e Apelit ka vlerësuar dhe arsyetuar rastin e parashtruesit të kërkesës nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të Gjykatës së Apelit. (Shih rastin KI29/17, të cituar më lart, paragrafi 58).
52. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtave të mbrojtura me nenet 22 dhe 44 të Kushtetutës në vendimin e kontestuar, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht ishte thirrur në ato nene, por nuk ka ofruar argumente të mtejshme në lidhje me këtë, përveç se shkeljen e këtyre neneve e ka lidhur me pretendimin se Gjykata e Apelit kishte

nxjerrë dy vendime të ndryshme në rrethana identike, dhe këtë Gjykata e trajtoi në pjesën e mëparshme të këtij aktvendimi.

53. Gjykata përsëri thekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vetëm fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës së Apelit apo të gjykatave të tjera të rregullta, sikundër edhe vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës apo instrumenteve ndërkombëtare, nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, paragrafi 33).
54. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 7 tetor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

